



RAPORT POLITIKASH KOSOVË



Konrad
Adenauer
Stiftung

KOSOVA PAS MARRËVESHJES SË BRUKSELIT:

NGA STATUS QUO-JA TEK SHTETI I NDARË ETNIKISHT NGA BRENDA

Dhjetor 2013

www.kas.de/kosovo

Ilir Deda

Drejtor Ekzekutiv

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të
Politikave (KIPRED)

1. Hyrje

Më shumë se pesë vjet nga shpallja e pavarësisë, dhe një vit pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrrur, Kosova përballet me dy realitete të veçanta sa i përket shtetësisë së saj dhe marrëdhënieve me jashtë: atë të një entiteti të pavarur dhe atë të një shteti të pavarur dhe sovran. Ajo trajtohet si një entitet i pavarur në marrëdhëniet e saj me institucionet euro-atlantike dhe shumicën e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, derisa Serbia e trajton atë edhe si territor të veçantë të qeverisur nga Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara dhe pjesë të saj. Në anën tjetër, Kosova trajtohet si shtet i pavarur vetëm në nivelin dypalësh nga shtetet të cilat e kanë njohur pavarësinë e saj. Por ka një disbalancë mes fushëveprimit dhe intensitetit të marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe që e pasqyrojnë dobësinë e legjitimitetit aktual ndërkombëtar të Kosovës dhe të akomodimit perëndimor ndaj politikës së "statusit neutral". Marrëveshja e Parë e Brukselit për Normalizimin e Marrëdhënieve në thelb iu dorëzua konceptit të zgjidhjeve në baza mono-etnike. Ajo shkon përtej Propozimit për Statusin Gjithëpërfshirës të Ahtisaari-it të harruar tashmë, dhe vendos bazë për një karakter të ri dy-kombësh të shtetit të ri.

Zbatimi i Marrëveshjes nuk do të shpie tek integrimi i serbëve të Kosovës në shtetin e ri. Në vend të kësaj, institucionet e reja dhe pushtetet e Bashkësisë së Komunave Serbe (BKS) do ta thellojnë ndarjen ndëretnike, kësaj herë të fuqizuar përmes një ndarje institucionale. Me një pranueshmëri të përgjithshme të juridiksionit ligjor të Serbisë mbi vendbanimet dhe komunat serbe në Kosovë, përderisa Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe përderisa kjo e fundit mbetet jashtë Kombeve të Bashkuara, ka më shumë shanse që marrëveshja e arritur në Bruksel do të jetë një status quo e re dhe një përpjekje tjetër për ndarje paqësore në vend të një përpjekje për të forcuar aftësinë e Kosovës të funksionojë si shtet plotësisht i pavarur i pakontestueshëm ndërkombëtarisht.

Zgjedhjet komunale të 3 nëntorit dhe rundi i dytë me 1 dhjetor e kanë ndryshuar në masë të madhe peizazhin politik të Kosovës. Pjesëmarrja e qytetarëve ishte e lartë, ku votuesit i shfrytëzuan garancitë e bashkësisë ndërkombëtare për zgjedhje të drejta dhe të lira

dhe i ndëshkuan partitë politike dhe rrjetet e tyre klienteliste. Humbja e rrjeteve klienteliste shënon fillimin e transformimit politik dramatik të Kosovës dhe sjelljeve votuese.

Pikëpamja perëndimore e lojës mes Prishtinës dhe Beogradit qëndron në shpresën e pabazë se Kosova një ditë do të njihet nga Serbia. Kjo politikë perëndimore është thellësisht e gabuar. Ajo e ngujon Kosovën në një shtetësi të papërfunduar afatgjatë, dhe në një proces të riorganizimeve të brendshme të vazhdueshme për ta bërë pavarësinë e Kosovës të pranueshme për Serbinë, derisa lehtësohet hyrja e Beogradit në BE. Kjo disbalancë e politikave e vë Kosovën në situatë edhe më të keqe se sa Bosnjën. Kosova është vënë një situatë ku në njërin anë shtetësia e saj kontestohet ndërkombëtarisht, derisa brenda e pranon bosnjëzimin gradual, duke e paguar çmimin për pranimin e saj nga Serbia si entitet i pavarur – jo si shtet – dhe për marrëdhëniet kontraktuale me Bashkimin Evropian (BE).

Parametrat aktual të këtij dialogu e ngrijnë status quo-n duke legalizuar situatën në terren – ndarjen e brendshme të Kosovës; qëllimin strategjik të Serbisë për ndarje; "neutralitetin ndaj statusit" të BE-së – duke e bërë atë të paqëndrueshme në planin afat-shkurtë e afat-mesëm me mundësinë e një konflikti potencial në periudhën afat-gjatë. Prandaj, procesi aktual i dialogut do të duhej të ndryshojë dukshëm me 2014, në mënyrë që të krijohen kushtet për normalizim të vërtetë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë dhe për të zvogëluar potencialin për destabilizim.

I. Ndikimi i zgjedhjeve komunale

Zgjedhjet komunale të 3 nëntorit dhe rundi i dytë i 1 dhjetorit e kanë ndryshuar në masë të madhe peizazhin politik të Kosovës. Pjesëmarrja e qytetarëve ishte e lartë, ku votuesit i shfrytëzuan garancitë e bashkësisë ndërkombëtare për zgjedhje të lira e të drejta dhe i dënuan partitë politike dhe rrjetet e tyre klienteliste. Humbja e rrjeteve klienteliste shënon fillimin e transformimit dramatik politik të Kosovës dhe sjelljeve të votuesve. Partitë më të votuara me 3 nëntor ishin Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 27.11%; Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 25.62%; Aleanca për Ardhmërinë e

Kosovës (AAK) me 14.03%; Lëvizja Vetë-Vendosje (VV) me 8.16% dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) me 4.94%. Skena politike e serbëve të Kosovës rezultoi me një dominim të tërësishëm të Iniciativës Qytetare "Srpska" (GIS) të përkrahur nga Beogradi me 49.42%; Partia e Pavarur Liberale e serbëve të Kosovës (SLS) me 19.49%; dhe partia e ndarë nga SLS Aleanca e Serbëve të Kosovës (SKS) me 6.00% të votave të serbëve të Kosovës. Partitë tjera më të vogla i mbledhën nismat tjera qytetare të serbëve të Kosovës. Por këto vota të përgjithshme për parti ndryshuan në rundin e dytë me 1 dhjetor, të cilat prodhuan fundin e dominimit të përgjithshëm të partive politike të etabluara mirë në Kosovë.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në pushtet i humbi shumicën e bastioneve të saj – Mitrovicën, Ferizajn, Gjilanin, Vitinë, Lipjanin, Malishevën por ruajti qendrën e dytë më të madhe urbane – Prizrenin dhe e fitoi Rahovecin dhe Kamenicën – duke marrë pushtetin në 10 prej 38 komunave. Partia kryesore opozitare – Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) u kthye në pushtet në shumicën e qendrave urbane – Pejë, Ferizaj, Gjilan por e humbi kryeqytetin Prishtinë, duke fituar në tërësi 9 komuna. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i humbi të gjitha bastionet e saj të rëndësishme – Pejën, Gjakovën, Suharekën, Rahovecin – duke u bërë një parti në pushtet në 3 komuna të vogla rurale – Deçan, Junik dhe Obiliq. Aleanca Kosova e Re (AKR) fitoi në Gjakovë dhe në Mitrovicën e Jugut; ndërsa Vetë-Vendosje (VV) fitoi në mënyrë spektakulare në kryeqytet në Prishtinë, ndërsa arriti rezultate shumë të dobëta në pjesën tjetër të vendit.

Ndryshimet e 1 dhjetorit në masë të madhe i anuluan votat popullore të partive të fituara me 3 nëntor duke rrënuar bastionet e PDK-së, LDK-së dhe AAK-së, duke i vënë ato në një pozitë shumë të vështirë dhe të paqartë në prag të zgjedhjeve kombëtare me 2014. PDK është në një rrëmujë të brendshme me lufta të brendshme partiake në rritje mes udhëheqësit të partisë kryeministrit Hashim Thaçi dhe zëvendësit të tij Kadri Veseli (ish shefi i inteligjencës jolegale partiake Shërbimi Informativ i Kosovës - SHIK). Tutje, PDK është duke u përballë me një ndarje të mundshme që është duke u udhëhequr nga ish nënkryetari i Partisë Fatmir Limaj dhe ish sekretari i përgjithshëm dhe kryetari aktual i Kuvendit Jakup Krasniqi.

Për LDK-në, humbja e Prishtinës e ka dobësuar momentumin e rritjes së partisë dhe pozitën e udhëheqësit të saj dhe ish kryetarit të Prishtinës Isa Mustafa. LDK ka treguar të jetë parti me struktura shumë të fuqishme lokale por përballet me një lidhësi qendror partiak të demoralizuar. AAK përballet me marginalizimin politik dhe krizën e rëndë të udhëheqësisë duke pasur parasysh personalizimin e udhëheqësit të fushatës zgjedhore të partisë. AKR – edhe pse fituesi i vetëm në krahasim me zgjedhjet e mëparshme komunale të vitit 2009 – nuk ka perspektivë premtuese për kalimin e pragut prej 5% për zgjedhjet e ardhshme kombëtare. VV është në situatën më të vështirë. Asaj i është dhënë kryeqyteti Prishtina, por e ka humbur votën popullore në të gjitha komunat tjera, duke e çuar në një krizë të udhëheqësisë dhe konceptit politik dhe ideologjisë së lëvizjes. Tutje, VV po përballet me një test të madh të aftësive të qeverisje dhe mundësisë për të ribrenduar vetën për zgjedhjet e ardhshme nacionale.

Krizat e lidhshimit në të gjitha partitë politike, humbja e klientelizmit dhe ndryshimi i përgjithshëm i sjelljes së votuesit i bëjnë shumë të paparashikueshme rezultatet e zgjedhjeve nacionale. Kjo më pas do t'i rritë kërkesat për të gjitha partitë politike pasi që të gjitha përballen me mungesën e aftësisë për të funksionuar në një mjedis politik të krijuar nga vota e drejtë dhe e lirë e qytetarëve të Kosovës.

Skena politike e serbëve të Kosovës ka pasur ndryshimet politike më dramatike. Beogradi e krijoi, përkrahu dhe financoi Nismën Qytetare "Srpska" (GIS) e cila grumbullon partitë qeverisëse në Beograd të bazuara në Kosovë dhe e cila fitoi 9 prej 10 komunave me shumicë serbe. Kjo fitore e ka marginalizuar plotësisht Partinë Liberale të Pavarur të serbëve të Kosovës (SLS) dhe të gjitha forcat tjera politike serbe. Si pasojë e Marrëveshjes së Parë të Brukselit mbi Parimet e Normalizimit të Marrëdhënive të 19 prillit, Beogradi është bërë akter i drejtpërdrejtë politik dhe një akter qeverisës në politikën vendore të Kosovës përmes Listës "Srpska". Kjo Listë do të bëhet forca politike dominuese e serbëve të Kosovës në zgjedhjet nacionale të vitit 2014 dhe me shumë gjasë forca e tretë politike e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës (përmes ulëseve të garantuara për pakica) dhe partia e ardhshme serbe në qeverinë e Kosovës në të

ardhmen. Kjo do ta bëj Serbinë partner faktik qeverisës në qeverinë e ardhshme të Kosovës.

II. Fundi i planit të Ahtisaari-t

Me 19 prill 2013, pas 10 rundeve të dialogut politik nën drejtimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian (BE) për Politikë të Jashtme dhe Siguri Catherine Ashton, kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë Hashim Thaçi dhe Ivica Dacic nënshkruan "Marrëveshjen e Parë të Parimeve Qeverisëse të Normalizimit të Marrëdhënieve" mes dy shteteve. Marrëveshja e parë iu dorëzua konceptit me zgjidhje monoetnike. Ajo krijon një ndarje institucionale etnike mes serbëve të Kosovës dhe të tjerëve, dhe paraqet goditje të përpjekjeve katërmbëdhjetë vjeçare të bashkësisë ndërkombëtare për të ndërtuar Kosovën si shoqëri dhe shtet shumë-etnik. Ajo shkon përtej Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin nga Ahtisaari (PGJS) – duke e interpretuar atë në mënyrë kreative, dhe ajo vë bazën për një natyrë të re të shtetit të ri. Derisa PGJS ofroi bazën për shtetin dhe shoqërinë shumë-etnike, Marrëveshja e Parë e Brukselit e ka transformuar natyrën e Kosovës në një shtet të papërfunduar dy-kombësh.

Marrëveshja krijon një qeveri faktike të serbëve të Kosovës (Asociacionin/Bashkësinë e komunave serbe) me garanci ligjore që bien ndesh me ligjin e aplikueshëm në Kosovë dhe rendin kushtetues të Serbisë¹. Në një situatë ku Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, garancitë ligjore do ta bëjnë Asociacionin/Bashkësinë organ institucional dhe administrativ lojal ndaj Beogradit dhe funksional brenda autoritetit të Prishtinës. Ky organ i ri qeverisës do të funksionojë në një kornizë statusore hibride, duke e marrë legjitimitetin e tij ligjor dhe funksionimin nga dy Kushtetuta kundërtëne. Kjo nënkupton sovranitet dhe bashkë-qeverisje të ndarë të Kosovës dhe Serbisë mbi serbët e Kosovës.

Marrëveshja e Parë po ashtu ka treguar paaftësinë e institucioneve qendrore të Kosovës për të ndërtuar një partneritet të vërtetë me serbët e Kosovës në jug të lumit Ibër, i dënoi ata për procesin e papërfunduar të decentralizimit, dhe drejtpërdrejtë pasqyron paaftësinë dhe/ose mungesën e vullnetit edhe të liderit të shqiptarëve në Kosovë dhe pranisë ndërkombëtare për të nisur ndërtimin e institucioneve të vërteta shumë-etnike. Në fund, ajo i është dorëzuar tutelës së Beogradit dhe investimit 14 vjeçar të Serbisë për të ruajtur ndarjen e serbëve të Kosovës nga Prishtina.

Kapitulli i 10 i Kushtetutës së Kosovës, neni 124 i përfshin dy forma të veçanta dhe reciprokisht të ndara të bashkëpunimit komunal që del nga Plani i Ahtisaari-t². E para është përmes një *asociacioni të komunave*, dhe e dyta përmes *partneriteteve komunale*. Asociacioni i komunave mund të krijohet nga komunat për të ofruar trajnime, ndërtim të kapaciteteve, asistencë teknike, hulumtime të politikave dhe rekomandime politikash për komunat.³ Asociacioni është organizatë jo-fitimprurëse.⁴ Prandaj, asociacioni ofron shërbime, organizon dhe koordinon aktivitete të anëtarëve të asociacionit, derisa promovon bashkëpunimin ndër-komunal. E dyta – partneritetet komunale – mund të formohen mes dy ose më shumë komunave për të ofruar shërbime të përbashkëta.⁵ Përmes partneriteteve komunat mund të bashkëpunojnë në kompetencat e tyre *vetanake* dhe të *avancuara*, por jo të *deleguara*.⁶ Prandaj përmes partneriteteve komunale mund të ekzekutojnë së bashku kompetencat e tyre dhe mund të ofrojnë shërbime të përbashkëta, por jo përmes një asociacioni të komunave. Marrëveshja e Parë i bashkoi këto dy forma të bashkëpunimit komunal – asociacionin dhe partneritetet, duke iu lejuar komunave të serbëve të Kosovës në mënyrë eksplicite që kolektivisht të ushtrojnë qeverisjen e përbashkët përmes Bashkësisë së Komunave serbe me kompetenca vetanake, të avancuara dhe të deleguara.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli i X, neni 124 (Qeverisja lokale dhe organizimi territorial)

³ Ligji për Vetë-qeverisje Lokale, Nr. 03/L-040; Neni 32.3

⁴ Statuti i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Neni 2.1

⁵ Ligji për Vetë-qeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Neni 29

⁶ Ligji për Bashkëpunimin Ndër-komunal, Nr. 04/L-010, Kapitulli 1, Nenet 2, 3.

¹ Pika 2 e "Parimeve qeverisëse për normalizimin e marrëdhënieve"

Marrëveshja e Parë i rendit pesë kompetenca të veçanta ekzekutive të Bashkësisë së Komunave Serbe në zhvillimin ekonomik, arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe rural. Ajo ka rol vendimtar në emërimin e komandantit rajonal të një rajoni të ri të Kosovës veriore – i përbërë prej katër komunave me shumicë serbe të Kosovës në veri të lumit Ibër – ku katër kryetarët e komunave do të ofrojnë një listë në emër të BKS-së. BKS do të qeveriset nga Statuti i BKS-së; do të ketë kryetarin, nën-kryetarin, Kuvendin dhe Këshillin (përfaqësuesit e këtyre strukturave do të zgjedhën pas zgjedhjeve të qeverisë komunale në Kosovën veriore); BKS mund të shpërbëhet vetëm me miratimin e komunave pjesëmarrëse.⁷

Si shtesë ndaj këtyre pushteteve, BKS po ashtu do të ketë rol përfaqësues si entitet i ndarë në institucionet qendrore të Kosovës dhe për këtë qëllim ka një ulëse të veçantë në Këshillin Konsultativ për Komunitete të Presidentes, duke përfshirë funksionin monitorues. Po ashtu, BKS do të menaxhojë "Fondin për Veriun", bashkë me BE-në dhe QeK; ajo do të marrë fonde të veçanta nga Serbia; do të marrë kompetenca shtesë nga Serbia pasi Beogradi ta miratojë ligjin kushtetues. Tutje, në Veri të Kosovës do të ekzistojë një kompani të re energjetike⁸ që do të furnizojë më rrymë, do të ofrojë shërbimet e shpërndarjes për konsumatorët në katër komunat me shumicë serbë në veri, dhe do të jetë në gjendje të blejë dhe shesë rrymë në tregun e hapur – në mënyrë të pavarur prej KEDS-it në Prishtinë. Në fushën e telekomit, i tërë territori i BKS-së së ardhshme dhe vendbanimet tjera me serbë të Kosovës do të mbulohen nga kompani të veçanta – filiale të Serbisë – në telefoninë fikse dhe mobile.⁹

Në gjyqësi, Marrëveshja kërkon krijimin e një ndarje të gjykatës së apelit, me një ulëse të përhershme në Mitrovicën e Veriut e përbërë nga gjykatësit dhe stafi administrativ. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themelojë një panel të përbërë nga një shumicë gjykatësish serbë të Kosovës që të merret ekskluzivisht dhe në

mënyrë të posaçme me 10 komunat me shumicë serbe. Ndarja gjyqësore e instancës së dytë krijon gjykatën faktike të apelit të serbëve të Kosovës.

Në polici, Marrëveshja krijon rajonin e policisë veriore të dominuar nga serbët etnik i përbërë nga katër komuna: Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi; me një serb të Kosovës si komandant rajonal të policisë në Kosovën veriore. Ndryshe prej komandantëve tjerë rajonal, komandanti rajonal serb i Kosovës do të propozohet nga katër kryetarët e komunave në emër të BKS-së dhe do të emërohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, jo në pajtim me Ligjin aktual për Policinë që përcakton se juridiksionet territoriale të rajoneve policore krijohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, i cili po ashtu i përzgjedh komandantët rajonal.¹⁰

Duke pasur parasysh aranzhimet e reja institucionale që i ofron marrëveshja e parë, është pak e mundshme që zbatimi i saj të shpie në integrimin e serbëve të Kosovës në shtetin e ri. Në vend të kësaj, institucionet e reja do ta thellojnë ndarjen ndër-etnike, kësaj herë të forcuar përmes ndarjes institucionale. Me juridiksion ligjor të Serbisë mbi vendbanimet dhe komunat e serbëve të Kosovës, përderisa Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe përderisa kjo e fundit mbetet jashtë Kombeve të Bashkuara, ka më shumë shanse që marrëveshja e arritur në Bruksel do të jetë një status quo e re dhe një përpjekje e re drejt ndarjes paqësore se sa përpjekje për të forcuar aftësinë e Kosovës për të funksionuar si shtet i pavarur dhe shumë-etnik. Kjo është tërësisht në pajtim me politikën e vazhdueshme të Serbisë për ndarjen e Kosovës, duke fuqizuar qëndrimin e ri të Beogradit për ndryshimin e mjeteve për arritjen e qëllimit të saj afat-gjatë.

III. Konteksti ndërkombëtar i shtetësisë së Kosovës

Që nga përfundimi i pavarësisë së mbikëqyrrur në shtator 2012, Kosova ka pranuar 13 njohje të reja, duke e sjellë numrin e tërësishëm të njohjeve në 104. Po ashtu, Kosova është bërë anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe

⁷ Ndryshe Asociacioni i Komunave të Kosovës mund të shpërbëhet me 2/3 e Kuvendit të Asociacionit ose nga institucioni shtetëror që e ka regjistruar Asociacionin në rastin kur anëtarët e Asociacionit nuk janë aktiv për një vit apo më gjatë.

⁸ Shiko Marrëveshjet sa i përket energjisë, pikat 4,5

⁹ Shiko Marrëveshjet sa i përket telekomunikimeve, pikat 3, 4.

¹⁰ Ligji për Policinë, Nr. 03/L-035, nenet 32,33.

Zhvillim (BERZH) në nëntor 2012; dhe u bë anëtare e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB) në qershor 2013. Megjithatë, perspektiva për anëtarësimin e Kosovës në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara (OKB), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), Organizata e Traktatit Veri-Atlantik (NATO) dhe BE mbetet e zbehtë. Përfundimi i parakohshëm i pavarësisë së mbikëqyrur tregoi mungesën e përkushtimit të përkrahësve të pavarësisë së Kosovës që të shohin legjitimitetin e plotë ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës të përfunduar me sukses. Në vend të kësaj, shpresat për arritjen e këtij synimi u vunë në dialogun me Serbinë.

Dialogu Prishtinë-Beograd i "lehtësuar" nga BE, pavarësisht nga Marrëveshja e Brukselit, nuk e ka ndryshuar qëndrimin e mos-njohësve të BE-së, edhe pse është pritur gjerësisht se do ta arrijë këtë. Pesë shtetet anëtare me më shumë gjasa nuk do ta ndryshojnë qëndrimin e tyre sa i përket pavarësisë së Kosovës në të ardhmen e afërt.

Pesë vite pas shpalljes së pavarësisë Kosova përballet me dy realitete të veçanta sa i përket shtetësisë së saj dhe marrëdhënieve me jashtë: atë të entitetit të pavarur dhe atë të shtetit sovran dhe të pavarur. Kosova trajtohet si entitet i pavarur në marrëdhëniet e saj me institucionet euro-atlantike dhe shumica e shteteve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, ndërsa Serbia e trajton atë edhe si territor të veçantë të qeverisur nga Rezoluta 1244 e KS të OKB-së dhe si pjesë të vetën. Ky është rezultat i akomodimit konkret të qëndrimit "neutral ndaj statusit" të këtyre institucioneve, duke përfshirë Kombet e Bashkuara. Përveç institucioneve ndërkombëtare ku Kosova ka anëtarësi si shtet i pavarur (Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, BERZH), të gjithë organizatat tjera shumëpalëshe e shohin Kosovën si entitet të pavarur, ku shumica prej tyre nuk lejojnë anëtarësimin për Prishtinën. Për me tepër, përmes "neutralitetit ndaj statusit" Kosova i është bashkuar një numri të kufizuar organizatash dhe rrjetesh rajonale të Evropës Jug-lindore. Kosova trajtohet si shtet i pavarur vetëm në nivelin dypalësh nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e saj.

Megjithatë, pjesa më e madhe e marrëdhënieve të Prishtinës me të tjerët përqendrohet në nivelin

shumëpalësh, kryesisht me BE-në ndërsa marrëdhëniet dypalëshe janë në nivel shumë më të ulët. Madje edhe shtetet njohëse janë të prira t'i përshtaten "politikës neutrale ndaj statusit" të agjendës shumëpalëshe – kryesisht duke e rforcuar këtë politikë në dialogun e Kosovës me Serbinë, duke rezultuar kështu me një shpresë të papërcaktuar afat-gjatë se Kosova një ditë do të njihet nga Serbia, duke e përmbyllur kështu legjitimitetin ndërkombëtar të saj. Kjo politikë perëndimore është thellësisht e gabuar. Ajo e ngujon Kosovën në një shtetësi të papërfunduar afat-gjatë, dhe një proces të riorganizimeve të brendshme të vazhdueshme për të bërë pavarësinë e Kosovës të pranueshme nga Serbia, derisa duke e lehtësuar hyrjen e Beogradit në BE. Kjo disbalancë e politikës e vë Kosovën në një situatë më të keqe se Bosnja. Legjitimiteti ndërkombëtar i Bosnjës nuk kontestohet, në vend të kësaj, shteti është kryesisht jofunksional për shkak të organizimit të brendshëm institucional i vendosur nga ndarja e brendshme e Marrëveshjes së Dayton-it. Kosova vëhet në situatë kur në njërin anë shtetësia e saj kontestohet ndërkombëtarisht, ndërsa në brendi pranon bosnjëzimin gradual, duke e paguar çmimin për pranimin nga Serbia si një entitet i pavarur – jo një shtet – dhe për marrëdhëniet kontraktuale me BE-në.

Me 2008 përkrahësit e pavarësisë së Kosovës dhe Kryeministri Hashim Thaçi kanë krijuar shpresën e pabazë se shteti i ri do të merrte më shumë se 100 njohje ndërkombëtare brenda muajsh, dhe brenda afërsisht 5 vjetëve Kosova do të bëhej anëtare e plotë e Kombeve të Bashkuara. Deri me 2011, ky ka qenë drejtimi i veprimeve edhe të përkrahësve të pavarësisë edhe të vet Prishtinës. Ishte fillimi i dialogut Kosovë-Serbi që ndryshoi drejtimin e përkrahësve drejt akomodimit të Kosovës si "entitet i pavarur" si rezultat i paaftësisë për të fituar përkrahje të plotë për njohjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

Tronditja e këtij ndryshimi ende është duke u mbajtur jashtë diskutimit vendor publik e politik në Kosovë. Kjo më së miri shihet në atë se si Qeveria e Kosovës e ka drejtuar vetën në dialogun me Beogradin, duke prodhuar pritje të pabaza dhe duke pranuar bashkë-qeverisjen me Serbinë mbi serbët e Kosovës, pa një zgjidhje të qartë të marrëdhënieve dypalëshe me Beogradin. Tutje, mosndëshkimi dhe korrupsioni dhe krimi



alarmues në nivelet më të larta politike të qeverisjes në Prishtinë, dhe dëshpërimi ekonomik, ka rezultuar në rënie dramatike të besimit në shtetësi nga vet kosovarët. Këto rrethana kanë krijuar një mjedis që nëse nuk ka ndonjë ndryshim afat-mesëm në statusin ndërkombëtar të Kosovës – anëtarësimi në OKB, kërkesat për shpërbërjen e shtetit dhe bashkimin me Shqipërinë do të bëhen diskursi i përgjithshëm politik, jo i kufizuar vetëm me Lëvizjen Vetë-Vendosje (VV).

IV. Parametrat e dialogut të lehtësuar nga Brukseli

Bashkimi Evropian është në prag të miratimit të fillimit të negociatave për anëtarësim me Republikën e Serbisë. Ky është rezultat i shfaqjes së fillimit të normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, proces i lehtësuar nga BE, kryesisht nga pranimi i "Marrëveshjes së Parë mbi Parimet e Normalizimit të Marrëdhënieve" e arritur në prill 2013. Marrëveshja e përkohshme nuk garanton kornizë shtetërore të sovranitetit për integrimin e plotë të pjesës veriore të Kosovës brenda Republikës së Kosovës; e as nuk përkufizon marrëdhëniet "normale" mes Kosovës dhe Serbisë në mungesë të njohjes reciproke. Tutje, ajo nuk e ka shtruar rrugën për përfshirjen e Kosovës në organizata ndërkombëtare, duke përfshirë Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Kosova është shtet thellësisht jostabil, edhe nga brenda edhe nga jashtë. Nga brenda përballet me sfida të rënda urgjente: 1) zënien e shtetit, krimin e organizuar dhe korrupsionin; 2) perspektivën e rrënuar për zhvillim ekonomik nën udhëheqjen aktuale. Nga jashtë, ajo ende përballet me funksionalitetin e kontestuar të shtetësisë së saj.

Politika afat-gjatë e Serbisë mbetet ajo e hegjemonisë rajonale që e "stabilizon" Bosnjën dhe Kosovën – duke kontrolluar drejtpërdrejtë Republikën Srpska në BeH dhe entitetin e ardhshëm "Bashkësi e Komunave Serbe" (BKS) në Kosovë. Në realitet, Beogradi është duke e vazhduar rolin destabilizues duke diktuar zhvillimet edhe në Bosnje edhe në Kosovë. Serbia synon të krijojë kushtet në terren të cilat do të favorizojnë – në një konstelacion të ndryshëm ndërkombëtar – që edhe RS edhe BKS (kryesisht pjesa veriore e Kosovës) t'i bashkohen

Serbisë. Në këtë qëllim politik strategjik afat-gjatë, Beogradi e ka përkrahjen e plotë të Moskës; dhe po ashtu motivohet nga mëdyshtja e Parisit dhe Romës, dhe nga lodhja e Uashingtonit me Bosnjën dhe Kosovën.

Zbatimi i Marrëveshjes së Parë të Brukselit mbi Normalizimin e Marrëdhënieve *nuk* do të shpie tek integrimi i serbëve të Kosovës në shtetin e ri. Në vend të kësaj, institucionet e reja dhe pushtetet e Bashkësisë së Komunave Serbe (BKS) do ta thellojnë ndarjen ndëretnike, kësaj herë të fuqizuar përmes një ndarje institucionale.

Marrëveshja siguron shtrirje të juridiksionit ligjor të Serbisë mbi vendbanimet dhe komunat e serbëve të Kosovës për një periudhë të përkohshme të papërcaktuar. Por, derisa Serbia nuk e njuh pavarësinë e Kosovës, dhe përderisa kjo e fundit mbetet jashtë Kombeve të Bashkuara, ka më shumë gjasa që marrëveshja e arritur në Bruksel të krijojë një status quo të re dhe një përpjekje tjetër për ndarje paqësore se sa një përpjekje për fuqizimin e aftësisë së Kosovës për të funksionuar si shtet i pavarur i pakontestuar ndërkombëtarisht.

Në mënyrë që të sigurojë "normalizimin" e mëtejme, Brukseli e ka vënë Kosovën në Kapitullin e 35 të bisedimeve për anëtarësim me Beogradin. Kështu, Serbia është në rrugë drejt sigurimit edhe të negociatave për anëtarësim me Brukselin edhe të kohës së mjaftueshme për arritjen e qëllimeve të saj strategjike për:

a) Ndarjen e Kosovës (rezultati i dëshiruar i Beogradit); ose

b) Krijimin e një Kosove faktikisht federale me sovranitet, pushtet dhe kontroll të përbashkët mbi entitetin e fuqishëm institucional e politik serb.

Me lidhjen e normalizimit të marrëdhënieve për negociatat për aderim të Serbisë në Kapitullin 35, Kosova bëhet peng i prioriteteve të politikës së Beogradit në vend të nevojës për një normalizim të shpejtë të marrëdhënieve.

Prioriteti i BE-së, në anën tjetër, është që së pari të hapen Kapitujt 35, 23 dhe 24 dhe t'i mbyllë ata të fundit në përfundimin e bisedimeve për anëtarësim, të cilat mund të zgjasin për një dekadë. Kjo e vendos Kosovën në një proces 10 vjeçar të normalizimit të marrëdhënieve me

Serbinë që nuk varet drejtpërdrejtë nga Prishtina, duke u bërë praktikisht jo-akter në përcaktimin e të ardhmes së saj.

Marrëveshja e Parë e Brukselit i jep hapësirë Serbisë të përdorë BKS-në si eksponent të saj në Kosovë në vend që të lejojë integrimin e serbëve të Kosovës brenda Republikës së Kosovës. Përmes BKS-së Beogradi do t'i ndajë serbët e Kosovës nga Prishtina dhe do ta bllokojë vendim-marrjen në nivelin nacional të Kosovës.

Serbia do të krijojë fakte në terren që praktikisht do ta nxjerrin Marrëveshjen e Brukselit jashtë përdorimit; derisa duke e shfrytëzuar atë në të njëjtën kohë si kartë kompromisi për koncesione tjera nga Prishtina. Beogradi do ta shtyjë tutje këtë qëllim duke përdorur parametrat aktualë të dialogut të Brukselit dhe dykuptimësitë e Marrëveshjes së Brukselit. Tutje, parametrat e Dialogut të Brukselit janë përcaktuar në atë mënyrë që për çdo pranim të subjektivitetit ligjor të Kosovës nga Beogradi, Prishtina duhet të bëjë kompromise në funksionimin e brendshëm të saj dhe në arkitekturën e saj institucionale për të plotësuar kërkesat e Beogradit. Ndjekja e parametrave e tillë, ritmi sipas të cilit Kosova është duke bërë kompromise për funksionimin e saj të brendshëm – në emër të paqes dhe stabilitetit afat-shkurtë – do ta dënojë Kosovën të jetë jofunksionale, dhe do të rrënohen të gjitha shpresat se Kosova nuk do të bëhet BeH tjetër në Ballkanin Perëndimor – duke kërcënuar paqen dhe stabilitetin rajonal afat-gjatë.

Pikëpamja perëndimore e lojës mes Prishtinës dhe Beogradit qëndron në shpresën e pabazë se Kosova një ditë do të njihet nga Serbia. Kjo politikë perëndimore është thellësisht e gabuar. Ajo e ngujon Kosovën në një shtetësi të papërfunduar afatgjatë, dhe në një proces të riorganizimeve të brendshme të vazhdueshme për ta bërë pavarësinë e Kosovës të pranueshme për Serbinë, derisa lehtësohet hyrja e Beogradit në BE.

Kjo disbalancë e politikave e vë Kosovën në situatë më të keqe se ajo në Bosnje. Kosova vëhet në situatë kur në njërin anë shtetësia e saj kontestohet ndërkombëtarisht, derisa nga brenda e pranon bosnjëzimin gradual, duke e paguar çmimin për pranimin e saj nga Serbia si entitet i pavarur – jo si shtet – dhe për marrëdhëniet kontraktuale me BE-në.

Parametrat aktualë të këtij dialogu e ngrijnë status quo-n duke legalizuar situatën në terren (ndarjen e brendshme të Kosovës; qëllimin strategjik të Serbisë për ndarje; "neutralitetin ndaj statusit" të BE-së) dhe duke e bërë atë të paqëndrueshëm në planin afat-shkurtë dhe afat-mesëm me mundësinë për konflikt potencial në periudhën afat-gjatë. Prandaj procesi aktual i dialogut duhet të ndryshojë rrënjësisht me 2014, në mënyrë që të krijojë kushte për normalizim të vërtetë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, dhe për të zvogëluar potencialin për destabilizim.

V. Reziqet me 2014

Pjesa më e madhe e vitit 2014 do të jetë vit zgjedhor në Kosovë, Serbi dhe BE. Edhe Kosova edhe Serbia do të mbajnë zgjedhje të reja nacionale, dhe ka po ashtu zgjedhje të rregullta për Parlamentin e BE-së, i cili më vonë do të zgjedhë Komisionin e ri të BE-së. Është e qartë se do të ketë boshllëk në dialog, por po ashtu edhe ndryshim të "adresës" të lehtësuesit – nga Përfaqësuesi i Lartë (PL) tek Drejtorati i Përgjithshëm (DP) për Zgjerim. Kalimi i dialogut aktual nga niveli i lartë politik në nivel teknik për "zgjerim" të normalizimit është në kohë të papërshtatshme, duke pasur parasysh mungesën e marrëveshjes gjithëpërfshirëse mes Kosovës dhe Serbisë. Një ndryshim i tillë ka më shumë gjasa që të shkaktojë jostabilitet dhe tensione se sa përmirësim të marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit. Tutje, sjellja e përgjithshme dominuese e Ashton dhe ekipit të saj ka qenë që të anashkalohen problemet, të minimizohen ato, e fokusuar në planin afat-shkurtë, duke minuar kështu stabilitetin dhe funksionalitetin e Kosovës dhe sfidat reale me të cilat Prishtina do të përballet në zbatimin e marrëveshjeve të dialogut me Serbinë. Nëse vazhdon ky mentalitet në lehtësimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve, ajo do të jetë një sfidë në vetvete.

Serbia ka shumë shanse që të mbajë zgjedhje të jashtëzakonshme gjatë pranverës 2014. Këto zgjedhje do të prodhojnë një qeveri të fortë të udhëhequr nga Partia Progresive Serbe (SNS) dhe nga udhëheqësi i saj Aleksandar Vucic. Kjo qeveri e re do të ketë stabilitet politik deri me 2018, do të negociojë për hyrjen në BE, dhe do të ketë ndikim të fuqishëm në çështjet e



brendshme dhe qeverisjen e Kosovës përmes GIS-së dhe BKS-së.

Zgjedhjet e Kosovës që do të mbahen gjatë verës 2014 me gjasë do të sjellin ndryshim në udhëheqje dhe partitë qeverisëse me një president(e), kryeministër dhe koalicion të ri qeveritar. Megjithatë, ndryshimi i pritur demokratik i Kosovës do të prodhojë një qeveri të dobët dhe të paqëndrueshme. Kjo brishtësi do të rrjedhë nga një koalicion i pashmangshëm prej disa partive politike shqiptare me GIS-në, e cila do të drejtohet nga Beogradi, duke përfshirë funksionimin e BKS-së. Kjo do t'i japë Beogradit pushtet me veto faktike për krijimin, ekzistimin dhe stabilitetin e qeverisë së re e po ashtu edhe për marrëdhëniet e BKS-së edhe me Beogradin edhe me Prishtinën. Praktikisht, Kosova do të bëhet një shtet dy-kombësh i ndarë institucionalisht edhe në nivel qendror edhe në nivel lokal.

Pranimi apo refuzimi i pavarësisë së Kosovës edhe nga BKS edhe nga GIS do të jetë thelbësor në përcaktimin e funksionimit e përgjithshëm të Kosovës në planin afat-mesëm. Kjo drejtpërdrejtë do të ndikojë në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, dhe nëse Beogradi dhe GIS mbesin kundërshtuese do të hapin mundësinë për konflikt. Një Kosovë e tillë e brishtë do të jetë e paaftë të bartë çfarëdo reformash të brendshme dhe do të jetë e paaftë të ketë një qëndrim të vendosur në dialogun me Beogradin.

Kosova nuk ka perspektivë të vërtetë drejt BE-së. Përmbyllja e mundshme e MSA-së deri në mesin e vitit 2014 nuk do të shpie tek hapi tjetër i Kosovës drejt anëtarësimit në BE – aplikimin për statusin e kandidatit. Hapi tjetër është peng i 5 shteteve mos-njohëse të BE-së që ndikon në mungesën e qëndrimit se çka është Kosova – a është shtet a jo. Në fund të vitit 2014 Kosova mund ta gjej vetën të ndarë nga brenda etnikisht e institucionalisht, jofunksionale, e bllokuar pas aderimit në BE, dhe pa legjitimitet të plotë ndërkombëtar dhe anëtarësim në OKB. Rrethanat e tilla përgjithësisht do të zvogëlojnë besimin e njerëzve të Kosovës në funksionalitetin e shtetit të tyre, dhe kërkesat për shpërbërjen e shtetit dhe bashkimin me Shqipërinë do të bëhen diskurs i përgjithshëm popullor e politik.

Qëndrimet e shprehura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorit dhe jodomsdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Konrad-Adenauer-Stiftung.

Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung

Zyra në Kosovë
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6
KO-10000 Prishtinë
Telefon +381 (0) 38 229 874
Prishtina@kas.de
www.kas.de/kosovo